



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1227/6 prot.

Datë 04.05.2026

V E N D I M
Nr. 583/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Anulimin e procedurës së prokurimit “Me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” me Nr. REF-80839-04-02-2026, me objekt “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale (MM2) për nevoja emergjente spitalore” për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë”, me fond limit 2 301 520,35 (dy milion e treqind e një mijë e pesëqind e njëzet pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “SoLed” SHPK me NIPT M42026032D dhe adresë: Kompleksi Lake View, Rruga Kristo Luarasi, Godina B, Kati 4, Hyrja B03, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik nuk ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye nuk legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.04.2026, autoriteti kontraktor Operator i Blerjeve të Përqendruara ka njoftuar operatorët ekonomikë për zhvillimin e procedurës së prokurimit “Me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” me Nr. REF-80839-04-02-2026, me objekt “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale (MM2) për nevoja emergjente spitalore” për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë”, me fond limit 2 301 520,35 (dy milion e treqind e një mijë e pesëqind

e njëzet pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 08.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 08.04.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 09.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE O.E.S DISTRIMED“ SHPK & “EUROMED ” SHPK 2,294,570 lekë kualifikuar

II.4. Në datën 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Në datën 22.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6573 dhe me nr. 1227/2026 prot., datë 22.04.2026 e operatorit ekonomik “SoLed” SHPK ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi me pretendimin si më poshtë:

“Procedura e prokurimit me negociim pa njoftim nuk është justifikuar zhvillimi i saj dhe është zhvilluar në mungesë konkurrence, duke mos na ftuar ne si Operator Ekonomik të interesuar.

Në datën 25.02.2026 është shpallur procedura standarde me objekt “Blerje materiale mjekimi konsumabël dhe kirurgjikale” nga autoriteti kontraktor “Operatori i Blerjeve të Përqendruara”.

“Soled” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 05.03.2026, e cila është pranuar pjesërisht me vendim të datës 19.03.2026.

Në kohën kur procedura ishte ende në proces dhe pritej vetëm heqja e pezullimit nga ana e KPP, në datën 02.04.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar një procedurë të re me negociim pa shpallje paraprake, duke përjashtuar në mënyrë të pajustificuar shoqërinë tonë nga pjesëmarrja.

Ky veprim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi cenon parimet themelore të barazisë, mosdiskriminimit, transparencës dhe konkurrencës së lirë dhe efektive. Përjashtimi i një operatori ekonomik aktiv dhe të interesuar, si shoqëria jonë, përbën kufizim artificial të konkurrencës.

Referuar nenit 47 të këtij ligji dhe nenit 52 të VKM nr. 285/2021, procedura me negociim pa shpallje paraprake mund të përdoret vetëm në kushte përjashtimore, të cilat në rastin konkret nuk rezultojnë

të provuara, pasi nuk ekziston asnjë urgjencë ekstreme e paparashikueshme, nuk është provuar mungesa e operatorëve ekonomikë në treg dhe nuk është argumentuar pamundësia për zhvillimin e një procedure konkurruese. Përkundrazi, rrethanat tregojnë se kjo procedurë është përdorur si mjet për të shmangur konkurrencën.

Autoriteti kontraktor, në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator, ka ftuar një numër të kufizuar operatorësh ekonomikë (në gjykimin tonë të përzgjedhur nga fituesit), pa përfshirë shoqërinë tonë, ndonëse ne jemi operator aktiv në këtë fushë, kemi shprehur interes të qartë dhe të dokumentuar përmes ankesës së mëparshme dhe kemi qenë subjekt ankues në procedurën fillestare, fakt i njohur nga vetë autoriteti kontraktor. Në këto kushte, mosftimi i shoqërisë sonë nuk mund të konsiderohet si një harresë administrative, por përbën përjashtim selektiv në kundërshtim me detyrimin për të garantuar konkurrencë reale dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Zhvillimi i një procedure të re në një kohë kur një procedurë tjetër me të njëjtin objekt ishte ende në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik përbën anashkalim të efektit të vendimmarrjes administrative, cenim të sigurisë juridike dhe krijon një precedent të rrezikshëm për integritetin e sistemit të prokurimit publik. Gjithashtu, fakti që janë ftuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë që përfitonin nga specifikimet e kontestuara më parë përbën indicie të forta të mungesës së paanshmërisë dhe të orientimit të procedurës drejt subjekteve të caktuara, duke cenuar besimin publik në këto procedura.

Shoqëria “Soled” sh.p.k. operon në këtë treg, ofron produkte objekt të prokurimit dhe disponon kapacitet të plotë teknik dhe financiar për realizimin e kontratës, gjë që mund të provohet përmes dokumentacionit përkatës, përfshirë bilancin financiar, xhiron vjetore, kontrata të ngjashme dhe dokumentacionin teknik si ISO, CE dhe katalogët përkatës.

Në këto rrethana, autoriteti kontraktor kishte detyrimin ligjor të ftonë shoqërinë tonë si operator ekonomik të interesuar dhe të identifikuar, duke qenë në dijeni të plotë të ekzistencës dhe interesit tonë konkret për këtë procedurë.

Mosftimi ynë përbën shkelje të nenit 2 dhe keqpërdorim të nenit 47 të ligjit nr. 162/2020, si dhe kufizim artificial të konkurrencës me indicie të qarta favorizimi.

Për sa më sipër, kërkojmë pranimin e ankesës si të bazuar, konstatimin e shkeljeve ligjore nga autoriteti kontraktor, anulimin e procedurës me negocim pa shpallje.”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1227/1 prot., datë 22.04.2026, me

pretendimet që operatori ekonomik “SoLed” SHPK kundërshton zhvillimin e procedurës së prokurimit me anë të ankesës së tij me nr. 1227 prot, datë 22.04.2026.

II.7. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike operatori ekonomik “SoLed” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumenta shtesë të cilat janë protokolluar me tonën nr.1227/2, datë 23.04.2026

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 2035/3 prot., datë 27.04.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1227/3 prot., datë 14.04.2026 me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur ng operatori ekonomik “SoLed” SHPK, lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr.REF-80839-04-02-2026, me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumabel dhe kirurgjikale (MM2) për nevojha emergjente spitalore për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë”*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzim të saj.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur pretendimin e operatorit ekonomik “SoLed” SHPK për *anulimin e procedurës me negociim pa shpallje me arsyetin se “Procedura e prokurimit me negociim pa njoftim nuk është justifikuar zhvillimi i saj dhe është zhvilluar në mungesë konkurrence, duke mos na ftuar ne si Operator Ekonomik të interesuar”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) *të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.2. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.3. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.*

III.1.4. Në nenin 110, pika 5 “Afatet për ankimim” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“5. Në rastin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit.*

Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimin të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumenteve të tenderit.”.

III.1.5. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.1.6. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

III.1.7. Neni 47, i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës mund të përdoret për kontratat publike të punëve, mallrave ose shërbimeve në secilin nga rastet e mëposhtme:

a) kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure të publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas kreut X të këtij ligji, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës me shpallje paraprake të njoftimit nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Një ofertë konsiderohet si e papërshtatshme, kur ajo nuk ka lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, të specifikuar në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për pjesëmarrje konsiderohet si e papërshtatshme kur operatori ekonomik në fjalë ndodhet në kushtet e skualifikimit, sipas nenit 76 të këtij ligji, ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor sipas nenit 77 të këtij ligji.

b) kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar për një nga arsyet e mëposhtme:

i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose performance artistike unike;

ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;

iii. për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.

Përgjashtimet e përcaktuara në nënndarjet “ii” dhe “iii” zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshem dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i kufizimit të kërkesave që autoriteti ose enti kontraktor përcakton për objektin e prokurimit.

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti ose enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negociim ose procedurat me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për kontratat e nënshkuara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj shkronje, nuk mund të përdoret procedura me negociim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen.

2. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake, mund të përdoret për kontratat publike të mallrave:

a) kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Kontratat që jepen në zbatim të kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit;

b) për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat janë ose një zëvendësim i pjesshem i mallrave apo instalimeve ose si shtesë e mallrave apo instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin ose entin kontraktor të marrë mallra me karakteristika të

ndryshme teknike, të cilat do të rezultojnë në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike joproportionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje.

Kontrata në këtë rast duhet të nënshkruhet nga autoriteti kontraktor brenda tre vjetëve nga lidhja e kontratës fillestare dhe vlera e këtyre furnizimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Situata e parashikuar në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj mallrash dhe shërbimesh që autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të vazhdueshme.

c) për mallrat e kuotuar dhe të blera në bursë;

ç) për blerjet e mallrave me kushte veçanërisht të favorshme, nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e tij tregtare, është në proces falimenti, nga një marrëveshje me kreditorët ose sipas një procedure të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake, mund të përdoret për kontratat publike të shërbimit kur kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me këtë ligj dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të ftohen të marrin pjesë në negociata.

4. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake, mund të përdoret për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti ose enti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë për të cilin është lidhur kontrata fillestare mbi bazën e një procedure konkurruese. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve ose shërbimeve shtesë dhe kushtet sipas të cilave ato do të jepen.

Situata e parashikuar në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj shërbimesh, për të cilat autoriteti kontraktor ka nevojë të vazhdueshme.

Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të bëhet i ditur që në momentin e shpalljes së procedurës së parë dhe autoriteti ose enti kontraktor gjatë përlllogaritjes së fondit limit duhet të marrë parasysh edhe një kosto të përgjithshme të punëve ose shërbimeve shtesë.

Kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda tre vjetëve nga data e lidhjes së kontratës fillestare dhe vlera nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

III.1.8. Në nenin 52 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47 të LPP-së, kur:

a) në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës, ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure të publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas kreut VIII të LPP-së, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës negociim me shpallje paraprake të njoftimit, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Ofertat dhe kërkesa për pjesëmarrje, konsiderohen si të papërshtatshme, kur mangësitë nuk kanë lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojnë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, të specifikuar në dokumentet e tenderit, si edhe kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit sipas nenit 76 të LPP-së, ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor sipas nenit 77 të LPP-së.

Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte apo kërkesë për pjesëmarrje nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit/entit kontraktor.

b) kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar, për një nga arsyet e mëposhtme:

- i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose performance artistike unike;*
- ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;*
- iii. për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.*

Përfshirjet e përcaktuara në paragrafët “ii” dhe “iii” zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm, dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i kufizimit të kërkesave që autoriteti/enti kontraktor përcakton për objektin e prokurimit. Ekzistenca e këtyre kushteve duhet të vërtetohet e të dokumentohet nga autoritetet ose entet kontraktore.

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti/enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, shërbimet e konsulencës, procedurat konkurruese me negociim, ose procedurat me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit në kontratat sektoriale, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti/enti kontraktor.

Në këtë rast, duhet të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. Konstatimi i një ngjarjeje të paparashikuar;*

- ii. Autoriteti/enti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;
- iii. Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë;
- iv. Nuk është e mundur të ndiqen procedurat konkurruese mbi ose nën kufirin e ulët monetar.

Në të gjitha rastet, autoriteti/enti kontraktor duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme e konstatuar, nuk është shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij.

Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme.

Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.

Për kontratat e nënshkuara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj shkronje, nuk mund të përdoret procedura me negociim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen.

ç) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të mallrave:

- i. kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Kontratat që jepen në zbatim të kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare, ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit.
- ii. për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat janë ose një zëvendësim i pjesshëm i mallrave apo instalimeve ose si shtesë e mallrave apo instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin ose entin kontraktor të marrë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultojnë në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike joproporcionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje.

Kontrata, në këtë rast, duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor brenda tre viteve nga lidhja e kontratës fillestare dhe vlera e këtyre furnizimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Situata e parashikuar në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj mallrash, për të cilat autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të vazhdueshme.

- iii. për mallrat e kuotuar dhe të blera në bursë;

- iv. për blerjet e mallrave me kushte veçanërisht të favorshme, nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e tij tregtare, është në proces falimenti, nga një marrëveshje me kreditorët ose sipas një procedure të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- d) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të shërbimit kur kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me LPP-në dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të ftohen të marrin pjesë në negociata.
- dh) Procedura me negociim pa shpallje paraprake mund të përdoret për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti/enti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është lidhur kontrata fillestare mbi bazën e një procedure konkurruese. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve ose shërbimeve shtesë dhe kushtet, sipas të cilave ato do të jepen.

Situata e parashikuara në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj shërbimesh, për të cilat autoriteti kontraktor ka nevojë të vazhdueshme.

Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të bëhet i ditur që në momentin e shpalljes së procedurës së parë, dhe autoriteti ose enti kontraktor, gjatë përlogaritjes së fondit limit duhet të marrë parasysh edhe një kosto të përgjithshme të punëve ose shërbimeve shtesë.

Kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda tre viteve nga data e lidhjes së kontratës fillestare, dhe vlera nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure.
3. Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikat 1, shkronja "b", 2, shkronjat "b", "c" dhe "ç", 3 dhe 4, të nenit 47, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë.

4. Kur autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, duhet të provojë se kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e nenit 76 dhe 77 të LPP-së.

5. Në rastin e procedurës së prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti/enti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave, duke krijuar mundësinë që operatorët ekonomikë të ftuar të kenë mundësinë e përgatitjes së ofertës dhe të jenë të mos diskriminohen.

III.1.9. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, në datën 14.04.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit. Në datën 22.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokoli 1227, e operatorit ekonomik “SoLed” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me anulimin e kësaj procedure prokurimi.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

Sa më sipër, KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimimi përpara KPP. Këto elementë janë interesi i ankuesit, dëmi real ose potencial i pritshëm dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor i marrë në kundërshtim me ligjin. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën.

Në rastin konkret, KPP konstaton, se operatori ekonomik ankimues “SoLed” SHPK, në ankesën e tij ka ngritur pretendime, duke kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit me arsyetimin se procedura e prokurimit me negociim pa njoftim nuk është justifikuar zhvillimi i saj dhe është zhvilluar në mungesë konkurrence, duke mos ftuar atë si operator ekonomik të interesuar.

Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon faktin se një operator ekonomik mund të kërkojë anulimin e procedurës nëse vërteton se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përdorimin e kësaj metode (psh. mungesa e emergjencës ekstreme apo rrethanave specifike teknike).

Përzgjedhja e procedurës negociim pa shpallje paraprake është një masë e jashtëzakonshme që duhet të përdoret vetëm në rrethana specifike të përcaktuara qartë në Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar që mund të jenë emergjenca e skajshme kur ndodh një ngjarje objektivist e paparashikueshme (jo e shkaktuar nga neglizhenca e autoritetit) dhe kërkohet ndërhyrje e menjëhershme ose mungesa e ofertave, kur në dy procedura të njëpasnjëshme (të hapura ose të kufizuara) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme, me kusht që kushtet fillestare të kontratës të mos ndryshojnë ose për arsye teknike ose të drejtat ekskluzive kur kontrata mund të ekzekutohet vetëm nga një operator i vetëm ekonomik për shkak të mbrojtjes së të drejtave të autorit ose pronësisë intelektuale.

E rëndësishme është që autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një argumentim të shkruar dhe të plotë për zgjedhjen e kësaj procedure, duke justifikuar ligjërisht emergjencën dhe arsyet teknike të cilat bëhen pjesë e dosjes së tenderit.

Autoriteti i përzgjedh vetë operatorët ekonomikë dhe negocion kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre. Procedura duhet të zhvillohet përmes Sistemit të Prokurimit Elektronik, dhe duhet të sigurohet që përdorimi i kësaj procedure të mos çojë në shmangien e konkurrencës apo diskriminimin e kandidatëve.

Në rastin konkret, referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE, komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ndodhur në kushtet kur procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar – Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi”, me REF-77193-02-24-2026 me objekt: “Blerje materiale mjekimi konsumabel dhe kirurgjikale”, me fond limit 16,341,122.67 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e dyzet e një mijë e njëqind e njëzetë e dy pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Leke pa TVSH ose 169,654.51 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e një) Euro Pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a., ishte në fazën e pezulluar për shkak të ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me modifikimin e DST si dhe emergjencës në të cilën ndodhej Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë për furnizimin me materiale mjekimi konsumi dhe materiale kirurgjikale, autoriteti kontraktor ka vlerësuar si të domosdoshme zhvillimin e një procedure prokurimi me negociim pa shpallje.

Ajo që konstaton Komisioni i Prokurimit Publik referuar dokumnetacionit të ngarkuar në SPE është se autoriteti në përzgjedhjen e kësaj procedure (Negocim pa shpallje) ka vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik duke argumentuar emergjencën për zhvillimin e kësaj procedure si dhe duke përzgjedhur operatorët ekonomik për shprehje interesi në përputhje me kërkesat e LPP. Theksojmë se përzgjedhja e operatorëve është e drejtë e autoritetit kontraktor mjafton që ajo të mos çojë në shmangien e konkurrencës apo diskriminimin e kandidatëve. Në rastin konkret rezulton se autoriteti kontraktori i ka dërguar ftesën për ofertë katër operatorëve ekonomikë, të cilët kanë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, ndërkohë që LPP përcakton detyrimin e AK për të ftuar jo më pak se tre operatorë ekonomikë.

Sa më sipër, në kushtet kur Komisioni i Prokurimit Publik e gjykon të ligjshëm procesin e zhvillimit të procedurës së Prokurimit “*Me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*” dhe për sa kohë që operatori ekonomik ankimues “SoLed” SHPK në ankesën e tij ka ngritur pretendime për një procedurë në të cilën nuk ka qenë i përzgjedhur nga autoriteti kontraktor për të paraqitur ofertë e rrjedhimisht jo pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ankimuesi nuk legjitimohet për të ushtruar të drejtën e ankimit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SoLed” për procedurën e prokurimit “*Me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*” me Nr. REF-80839-04-02-2026, me objekt “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale (MM2) për nevoja emergjente spitalore” për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Korçë”, me fond limit 2 301 520,35 (dy milion e treqind e një mijë e pesëqind e njëzet pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar zhvilluar më datë 08.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SoLed” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

